



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12.3.2025

Nr: 263

Ora: 19:00

VENDIM
PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 225, DATË 28.2.2025, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE “PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “ALEANCA EUROPIANE EKOLOGJIKE”, ME KRYETAR Z. SAZAN GURI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot, më datë 12.3.2025, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1334/1 prot., datë 10.3.2025, me:

- KËRKUES:** Partia Politike “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, me kryetar Z. Altin Goxhaj
- OBJEKTI:** Ndryshimin e të dhënave të Partisë “Aleanca Europiane Ekologjike” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë” dhe të zëvendësimit të kryetarit z. Sazan Guri me kryetarin z. Altin Goxhaj, sipas vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Sazan Guri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 4.12.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me initiale “AEE”, me Kryetar Z. Sazan Guri, ku rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

Data: 12.3.2025 Nr: 263
Ora: 19:00



Për disa ndryshime në vendimin nr. 225, datë 28.2.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me Kryetar Z. Sazan Guri, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Me vendimin nr. 225, datë 28.2.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me kryetar Z. Sazan Guri, me shkronjat nistore “AEE”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

Në datë 10.3.2025, z. Altin Goxhaj ka depozituar kërkesën nr. 1334/1prot., me objekt ndryshimin e të dhënave të Partisë “Aleanca Europiane Ekologjike” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë” dhe të zëvendësimit të kryetarit z. Sazan Guri me kryetarin z. Altin Goxhaj, sipas vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vendimi nr. 8, datë 21.2.2025, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të cilit është vendosur “Ndryshimi i emrit të partisë, nga “Partia Aleanca Europiane Ekologjike” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, me akronimin “AKPSH”.
- b) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 11.3.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se: “Me vendimin nr. 8, datë 21.2.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të cilit është vendosur “Ndryshimi i emrit të partisë, nga “Partia Aleanca Europiane Ekologjike” në “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, me akronimin “AKPSH” dhe me kryetar të partisë z. Altin Goxhaj”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Ndryshimin e të dhënave të subjektit zgjedhor Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, (AEE), me kryetar Z. Sazan Guri, në Partia “Aleanca Konservatore për Shqipërinë”, (AKPSH), me kryetar z. Altin Goxhaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI